

Këshilla për praktika të mira

Unë jam prind. Për ta përdorur Disiplinën Pozitive duhet të planifikoj paraprakisht:

Duke menduar për qëllimet e mia afatgjata. A do të doja që fëmijët e mi të jenë me vetëbesim apo të pasigurt në vete? Të lumtur apo të zemëruar? Jo të dhunshëm apo agresivë? A janë veprimet e mia duke më dërguar te qëllimet e mia?

Duke menduar se si do të sigurohem që fëmijët e mi janë të sigurt emocionalisht dhe fizikisht edhe kur jam i frustruar. Si do t'ua dëshmoj atyre se i dua dhe se nuk do t'i lëndoj nëse ata bëjnë gabime?



Duke menduar se si do të komunikoj në mënyrë të qartë dhe me respekt. Si do t'u jap fëmijëve të mi informatat që u duhen, në mënyrë që të mësojnë dhe të arrijnë sukses?

Duke menduar mbi pikëpamjet e fëmijës tim. Fëmijët mendojnë ndryshe, varësisht nga mosha, kështu që arsyet për sjelljet e tyre ndryshojnë – sikur që ndryshojnë mënyrat me të cilat ne i mësojmë.

Kur mendoj mbi qëllimet e mia afatgjata, si do t'ju siguroj ngrohtësi dhe strukturim; si dhe, si mendojnë dhe si ndihen fëmijët e mi, unë mund të planifikoj një përgjigje për çdo situatë, e cila do t'i mësojë ata, çka në të vërtetë unë dua që ata të mësojnë.

Save the Children denoncon përdorimin e dënimit fizik dhe formave të tjera poshtëruese, si dhe trajtimin degradues, si: dhunimin e të drejtave themelore të fëmijës.

Save the Children beson që asnjë shkallë e dhunës kundër fëmijëve, në emër të disiplinës, nuk duhet të aprovohet nga shoqëria ose të jetë e ligjshme.

Save the Children angazhohet të sigurojë që të gjithë fëmijët janë të mbrojtur nga çdo formë e dhunës në të gjithë globin.

Save the Children punon për:

- Një botë, e cila respekton dhe vlerëson çdo fëmijë;
- Një botë, e cila i dëgjon fëmijët, dhe
- Një botë, ku të gjithë fëmijët kanë shpresë dhe mundësi.

Gazmend Zajmi nr.1, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 23 26 91
Fax: +381 (0) 38 23 26 93
scik@savethechildren.org
www.savethechildren.net
kosovo.savethechildren.net
www.facebook.com/savethechildreninkosova/o

Si pjesë e sistemit të llogaridhënies së Save the Children: Nëse keni ndonjë ankesë, pyetje apo informatë kthesë (feedback), ju lutem ndani me ne në: scik@savethechildren.org

DUKE MËSUAR FËMIJËT:

JO goditjeve dhe poshtërimit
PO informimit, respektit dhe pjesëmarrjes



Save the Children



SWEDEN

Ky material/botim është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materiali e mban plotësisht hartuesi. Qeveria e Suedisë nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim.

JO...

Goditjeve dhe poshtërimit të fëmijëve

Prindërit godasin dhe poshtërojnë fëmijët kur janë të lodhur ose të stresuar, ose kur besojnë se ajo është mënyra për t'i disiplinuar fëmijët e tyre.

POR...

Goditja, poshtërimi dhe metodat e tjera të dhunës:

- dëmtojnë fëmijën fizikisht
- e ulin vetëbesimin e fëmijës
- i bëjnë fëmijët të ndihen të pasigurt dhe më depresiv
- i inkurajojnë fëmijët të jenë agresivë
- krijojnë zemërim dhe pakënaqësi, duke dëmtuar marrëdhënien prind-fëmijë

Dënimi fizik dhe poshtërimi NUK e mësojnë fëmijën për atë çka ne dëshirojmë të mësojë.

PO...

Informimit, respektit dhe pjesëmarrjes

Disiplina nënkupton mësimin. Disiplina Pozitive është një qasje edukimit, e cila e drejton sjelljen e fëmijës, dhe në të njëjtën kohë, duke respektuar të drejtën e tyre për një mjedis të sigurt, mbrojtje nga dhuna, si dhe pjesëmarrje në edukimin e tyre.



Unë jam një prind.

Çka duhet të bëj ta edukoj dhe ta udhëzoj fëmijën tim?

1. Përkujto qëllimet e tua afatgjata

Duke mbajtur në mendje qëllimet e tua afatgjata, siç janë: edukimi, respekti dhe mos-dhuna, ju mund t'i shmangeni reagimit afatshkurtër, siç janë goditja ose ngritja e zërit.

2. Sigurohu që fëmija juaj është i sigurt emocionalisht dhe fizikisht

Fëmijët kanë nevojë t'i praktikojnë aftësitë e tyre duke u rritur, në mënyrë të sigurt, pa u goditur ose kritikuar kur bëjnë ndonjë gabim.

3. Komunikoj qartë dhe me respekt

Ka më shumë gjasa që fëmijët t'i respektojnë limitet e tua, nëse ti je i respektueshëm ndaj tyre.

4. Kupto pikëpamjet e fëmijëve

Nëse bisedon me fëmijët e tu, i dëgjon ata dhe përpiqesh t'i kuptosh pikëpamjet e tyre, do të bëhesh mësues shumë më i mirë.

5. Zgjidhja e Problemit

Për t'i edukuar mirë, duhet t'i mendosh gjërat në tërësi, të planifikosh paraprakisht dhe të përgjigjesh qetë.



Si mendojnë dhe ndihen fëmijët në mosha të ndryshme

0-6 muaj. Foshnjat e vogla komunikojnë përmes të qarit. Ata kanë nevojë të besojnë se ne i dëgjojmë dhe iu përgjigjemi.

6-12 muaj. Foshnjat më të rritura nuk kuptojnë se gjërat ekzistojnë edhe kur nuk i shohin. Ata qajnë kur ne largohemi, sepse frikësohen se nuk do të kthehemi. Ata duhet të dinë se mund të na besojnë se jemi afër.

1-2 vjet. Fëmijët mësojnë duke eksploruar dhe duke prekur, shijuar dhe gjuajtur gjëra. U duhemi atyre për t'ua bërë mjedisin më të sigurt, në mënyrë që ata mund të eksplorojnë dhe t'i zhvillojnë aftësitë e tyre.

2-3 vjet. Imagjinata në rritje e fëmijëve mund të çojë deri te frika. U nevojitemi atyre për t'i respektuar ndjenjat e tyre dhe për t'u ofruar siguri.

3-5 vjet. Parashikimet mësojnë duke luajtur dhe duke bërë shumë pyetje. Ne duhet ta respektojmë nevojën e tyre për lojë dhe t'u sigurojmë një mjedis të sigurt. Ne duhet, gjithashtu, t'i dëgjojmë pyetjet e tyre dhe t'u përgjigjemi me respekt.

5-9 vjet. Kur fëmijët hyjnë në shkollë, ata ballafaqohen me pritje të reja dhe zhvillojnë shoqëri të re. Ne u duhemi atyre që t'u tregojmë si t'i trajtojnë sfidat dhe si t'i zgjidhin konfliktet pa dhunë.

10-13 vjet. Para-adoleshentët kalojnë më shumë kohë me shokë dhe duke shqyrtuar besimet dhe vlerat e tyre. Ne u duhemi që t'i mbajmë të sigurt dhe duke respektuar nevojën për pavarësi gjatë rritjes.

14-18 vjet. Adoleshentët mundohen të kuptojnë kush janë. Ata provojnë identitete të ndryshme, duke parë cila u përshtatet më shumë. Ne duhet t'i respektojmë dëshirat e tyre për pavarësi dhe të besojmë tek ata.

Mëso dhe praktiko aftësitë e Disiplinës Pozitive me: Disiplina Pozitive: Çka është dhe si të bëhet ajo
http://seap.savethechildren.se/en/South_East_Asia/Publications/Abuse/